



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM PËR MEDIA**

Ditën e enjte, në datën 18 mars 2021, në mjediset e AMA-s dhe përmes mjeteve të komunikimit elektronik në distancë, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>

AMA, në këtë mbledhje:

- Diskutoi nbi angazhimin e deritanishëm të Autoritetit të Mediave Audiovizive në zbatim të detyrimeve të Kodit Zgjedhor.
- Mori në shqyrtim ankesën e z. Arbër Kote ra dakord t'a rrëzojë këtë kërkesë duke e gjetur qëndrimin e mbajtur nga Këshilli i Ankesave në përputhje me legjislacionin në fuqi.

AMA pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Miratimin e rregullores “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Autoritetin e Mediave Audiovizive” (**Vendimi nr. 43, datë 18.03.2021**)
2. Miratimin e raportit vjetor të veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive, për vitin 2020”. (**Vendimi nr. 44, datë 18.03.2021**)
3. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Radio Klan” sh.a., licencuar për subjektin audio kombëtar “Radio Klan”. (**Vendimi nr. 45, datë 18.03.2021**)

AMA në këtë mbledhje mori në shqyrtim projektregulloren “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e autorizimit për përdorimin e frekuencave të brezit HF, për ofrimin e shërbimit audio” dhe projektvendimin “Për disa shtesa në vendimin e AMA-s, nr. 220, datë 01.12.2017 “Për miratimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive” dhe ra dakord të shtyjë vendimmarrjen për këto akte në mbledhjen e tij të radhës.

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**Tiranë, më 18.03.2021**